

## **RELACION TEKNIK**

**OBJEKTI:** "NDËRTIM K.U.Z LAGJA "DERVINA", FSHATI ARRAMERAS, NJ.A.FUSHË KRUJË".

**POROSITËS:** BASHKIA KRUJË.

**VENDODHJA:** FSHATI ARRAMERAS, NJ.A FUSHË KRUJË, BASHKIA KRUJË.

### **A.TË PËRGJITHSHME.**



Fush-Kruja ndodhet rreth 20 km ne veri te qytetit te Tiranes. Shtrihet rreth kuotes 25m mbi nivelin e detit, eshte krejtesisht zone fushore, me pjerresi te terrenit 1-5% me drejtim lindje-perendim. Ne afersi te saj ka disa kodra te vogla me lartesi 80-120m mbi ninivelin e detit.

Rritja e ritmeve te zhvillimit ne vendin tone, dhe atij turistik ne veçanti, kerkojne investime te vazhdueshme si per permiresimin e rrjetit rrugor ekzistues, po ashtu edhe te ndertimit te rrugeve te reja per t'iu perqigjur trafikut gjithmone ne rritje.

Drejtoria e Planifikimit te Territorit ne baze te termave te references (detyres se projektimit), ka kryer studim-projektimin e kesaj zone per objektin "Ndërtim KUZ lagja "Dervinëve", fshati Arrameras, Nj.A.Fushe Kruje, Bashkia Krujë" e cila ka kaluar te gjitha fazat sipas programit te hartuar, duke filluar nga:

- Projekt idea
- Takime ne Njësinë Administrative të F-Krujës e Bashkisë Krujë.

Projekti permban:

1. Studimin e Projekt Idese
2. Relacionin teknik qe permban nje pershkrim te per gjithshem per zonen, te dhena mbi gjendjen ekzistuese te zones, pershkrimin mbi hartimin e projektit, llogaritjet e tubacionit dhe shtresave mbi to, llogaritjet konstruktive, etj.
3. Specifikimet teknike
4. Grafikun e zbatimit te punimeve
5. Vizatimet e punes si: planimetrine e per gjitheshme te ndertimit, profilin gjatesor, profilat terthore tip, planimetrite e disiplinimit te ujrave, vizatimet konstruktive, te gjitha detajet dhe hollesite, etj.
6. Preventivin perfundimtar per fazen e projekt zbatimit te ndertimit te objektit.

Si projektues per hartimin e projektit jemi bazuar tek standartet dhe kushtet teknike shqiptare (keto kushte teknike shtrihen ne studimin dhe projektimin e Ujeselles-Kanalizimeve te Republikes se Shqiperise). Per veprat e artit jemi bazuar ne kushtet teknike te projektit per rruge te kategorise se dyte.

## Bashkia e Kruje Pozita Gjeografike

Qyteti i Fushë-Krujes perfshihet ne Zonen qendrore të Shqipërisë. Zona e Fushe-Krujes kufizohet ,ne verilindje me Krujen ne jug me Tiranen,ne veri ne Lac. Siperfaqja eshte 44 km<sup>2</sup>. Popullsia totale eshte rreth 30 0000 banore. Perfshin 6 fshatra. Dendesa mesatare 655.3 banore per km<sup>2</sup>. Popullsia qytetare 66.2%, popullsia fshatare 33.8%. Rritja natyrore 1.54%.

Mbizoteron reliivi fushor kodrinor. Lartesia mesatare e Qyetit eshte 25 m mbi nivelin e detit. Kodrat kryesore:Shqopes(111,7 m), Kodra e Bacungut (157 m), Kodra e Lagjes (383 m) etj.

Te gjitha te dhenat mbi popullsine e Fush-Krujes u dhane nga ish Bashkia e qytetit (sot Nj.A F-Krujë) dhe ne detyren e projektimit.

## **KLIMA**

Në nënzonën mesdhetare jugore ndryshimi ditor i temperaturës shkon nga një minimum rrëth agimit, në një maksimum nga 1 deri 3 orë mbasi dielli ka aritur në zenith, mbas të cilës ka një rënje të vazhdueshme gjate natës deri në agim.

Temperatura mesatare ditore është mesatarja e temperatures maksimale dhe minimale dhe normalisht është brenda kufirit të mesatares të vertetë që regjistrohet në mënyrë të vazhdueshme

Temperatura është matur në gradë Celsius (°C). Nga vrojtimet e deritanishme rezulton se maksimumi absolut i temperaturës së ajrit është 39.5 gradë. Në Shqipëri ne shtresën e ajrit që është 2m larg sipërfaqes së tokës konstatohet një amplitudë e lartë termike prej 68.2 grade,kjo është një vlefte e ndjeshme por gjithnjë karakterizuese për vendet mesdhetare, me një relief të thyer siç është Fush-Kruja.Temperatura mesatare vjetore ne Fush-kruje eshte 15.3°C.Temperatura mesatare e janarit 5.8°C, e korrikut 26.6°C, temperatura absolute me e ulet ne Fush-kruje eshte -13°C, me e larta absolute 38.1°C. . Reshjet mesatare vjetore 1618 mm për Fush-Krujen.Kjo zone karakterizohet nga diferenca te medha intesitetesh reshjesh

## **POPULLSIA**

Te gjitha te dhenat mbi popullsine e Fush-Krujes u dhane nga ish Bashkia e qytetit dhe ne detyren e projektimit.Popullsia e qytetit te Fush-Krujes deri ne vitin 2022 nga te dhenat e ish Bashkise eshte 15000.Studiusit demografe jepin te dhena te peraferta me ato te Bashkise se Fushë-Krujes.

Nje pjese e popullsise jeton ne banesa 2-5 kate dhe pjesa me e madhe jeton ne banesa private 1-2 kate.Popullsia e pritshme e qytetit deri ne vitin 2030 eshte 30000 banore.

Nje perqendrim i tille eshte verejtur veçanerisht pas vitit 1990 me lejimin e levizjes se lire te njerezve dhe shtimin e ndertimeve te shumta.

## **EKONOMIA**

F-kruja renditet ne qendrat me nje zhvillim te mire ekonomik, tregtare te vendit. Jo vetem qyjeti i F-krujes, por i gjithe rrathi ne teresi ka luajtur historikisht nje rol shume te rendesishem ne zhvillimin ekonomik te krejt vendit.

Ne kete zone jane te mundshme per tu zhvilluar te gjitha aktivitetet ekonomike. Megjithate midis tyre vlen te veçohen sektore te tille si industria e cementos, e mobilerise, ekonomia buqesore.

### **- Rilevimi Topografik dhe Hartat Baze.**

Rilevimi topografik i nevojshem eshte kryer me metoden Total- station.

Pikat topografike do te vendosen gjate procesit te rilevimit. Ato jane kunja celiku me bazament ose shenjim ne ndertime te perhershme. Nivelet e pikave topografike do te

bazohen ne te dhenat Shqiptare; afersisht gjashte do te vendosen ne cdo kilometer kator ne zonat e banuara dhe cdo 300-500m per gjate rrugeve te hyrjeve.

Te gjitha hartat jane ne formate elektronike bashke me nje pale kopje te riprodhueshme.

° Jane percaktuar ndertimet e perhershme dhe te perkohshme, shkarkimi I ujrave te zeza , muret rrethuese, gardhet portat e hyrjeve, kufijte e parcelave. Jane treguar objektet ne ndertim.

° Ne planimetri jane dhene tubat kryesore dhe pusetat e kontrollit te shtrira ne siperfaqen e tokes.

° Jane dhene dhe percaktuar linjat e Energjise Elektrike, linjat e tensionit,shtyllat,transformatoret, lidhjet me banesat, ndricimi rrugor.

° Ne punimet topografike jane hedhur rruget dhe kalimet, dallohen rruget e shtruara dhe gjurmet e tyre.

Rrjeti telefonik do te tregohet dhe te percaktohen linjat , kabinat telefonike etj.

Hartat e perdonura per hartimin e ketij projekti , jane ne shk.1:500,1:1000,1:2000 dhe 1:10000. Ne hartat baze te zones ne shkallen 1:1000 dhe 1:500 te siguruar nga DPKZHT eshte hedhur azhornimi i zones me kuotat gjeodezike te zones, ka azhornim te banesave te reja te ndertuara ne kete zone ne 10 vitet e fundit.

Projekt-zbatimi eshte punuar mbi hartat e shkalles 1:500 dhe 1:200 etë tjera sipas detajeve, te marre nga Drejtoria e D.P.K.ZH.T-se.

Fshati Arrameras Fushe Kruje, me popullesi rreth 1800 banore, shtrihet ne anen veri lindore te qytetit Fushë Krujë dhe kufizohet me qytetin Fushë Krujë ne anen jug-perendimore me fshatin Halil ne anen lindore, ne anen jugore me fshatin Larushk dhe ne anen veriore me rrugen nationale Fushe Kruje-Kruje. Pranë "Kodres se Bilbilave" ndodhet lagja e Dervineve.

Në këtë zonë ka një numër mjaft të madh biznesesh që ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë zonë.

Duke patur parasysh numrin e madhe te banesave qe i sherben kjo kuz, referuar afersise me qytetin dhe vleres se vogel te investimit qe kerkon, lind si domosdoshmeri kryerja e ketij investimi.

## **B.SHTRIRJA GJEOGRAFIKE E KANALIT.**

Lagja e Dervineve shtrihet ne anen lindore te qytetit Fushë Krujë, ne jug te rrugës nationale Fushë Krujë-Krujë.

Kjo lagje ka një popullesi prej 70 banorësh dhe aktualisht mungojnë kanalizimet e ujërave të zeza dhe janë me gropë septicë, kjo përfshirë faktin e pamundësisë teknike dhe financiare përfshirë në projektin bazë.

Meqenëse aktualisht është e mundur realizimi i projektit për perfshirjen ne rrjetin kuz edhe të kësaj lagjeje, bashkia ka hartuar projektin per kete qellim.

### **C.GJENDJA EKZISTUESE E KANALIZIMEVE.**

- Aktualisht banorët e kësaj lagjeje i shkarkojnë ujërat e zeza me gropë septike, duke u bere një burim infekzioni per banoret, pa llogaritur dhe shkallen e urbanizimit të lagjes e cila domosdoshjmerisht kerkon krijimin e një rrjeti kuz.

Duke qenëse është një lagje relativisht e mbledhur dhe për sistemimin e ujërave të zeza të tyre ka zgjidhje dhe mundësi teknike që të shkarkohen kolektorin kryesor pranë kryqëzimit të Unazës së madhe, bashkia Krujë ka menduar që të sistemojë këto ujëra me tubacion HDPE që mendohet të ndërtohet në aksin pranë rrugëve së lagjes te cilat do te lidhen me tubacion d=200mm e 315mm.

Për këtë qëllim, kemi hartuar projekt preventivin e zbatimit i cili ka parashikuar ndërtimit e kolektorit me tubacion HDPE nga 200mm 315mm, me pusetat respektive të kontrollit (11 copë 50x50x100cm, 3 copë 80x80x100cm), si dhe eshte parashikuar shkarkimi në kolektorin kryesor në aksin e rrugës.

#### **RELATOI:**

**“HMK CONSULTING” SH.P.K**

**ING.HEKURAN HOXHALLI**